



*EC Ma Ndryshe, Dokufest, Fondacioni për Trashëgimi Kulturore, Forumi për Trashëgimi Kulturore, Academy for Training and Technical Assistance, N'GO, Instituti Demokratik i Kosovës – dega në Prizren dhe X40*

22 gusht 2011

## REAGIM

*...i OJQ-ve në Prizren në lidhje me procesin e hartimit dhe miratimit të projekt-ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit*

Ne organizatat e poshtënjshkruara jo-qeveritare, aktive në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore dhe konsultimeve e pjesëmarrjes publike në vendimmarrje, që veprojmë në Prizren, shprehim pakënaqësinë tonë lidhur me procesin e hartimit dhe miratimit të projekt-ligjit për qendrën historike të Prizrenit. Procesi i hartimit të këtij projekt-ligji, që zgjat rreth dy vjet, ka dëshmuar për qasjen përjashtuese të institucioneve shtetërore të Kosovës dhe faktorit ndërkombëtar, ndaj shoqërisë civile dhe qytetarëve kur bëhet fjalë për trashëgiminë kulturore. Gjatë ditës së sotme, ky projekt-ligj është shqyrtuar në Komisionin Parlamentar për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, para se të procedohet për miratim në seancën e ardhshme plenare të Kuvendit të Kosovës.

Vërejtja jonë kryesore lidhet me mbylljen e procesit të hartimit të këtij projekt-ligji. Prandaj, nga Komisioni përkatës parlamentar kërkojmë që urgjentisht të iniciojë një proces të diskutimit publik, gjatë të cilit do të rishikohet edhe një herë e gjithë përmbajtja e projekt-ligjit. Diskutimi publik – që duhet të ofroj kohë të mjaftueshme – duhet të përfshijë të gjitha palët relevante të Prizrenit, e posaçërisht shoqërinë civile, komunitetin afarist, komunitetet fetare, pronarët e shtëpive dhe qeverinë lokale. Jemi të shqetësuar se miratimi i këtij projekt-ligji në Kuvendin e Kosovës, pa përfshirjen e palëve të lartpërmendura në hartimin e tij, do të krijojë bazë për konflikte të ardhshme mes komuniteteve të Prizrenit, si dhe për ngufatjen e potencialit zhvillimor të qytetit.

Në vijim janë vërejtjet tona kryesore për përmbajtjen e këtij projekt-ligji:

- Procesi i mbyllun – i gjithë procesi i hartimit të projekt-ligjit për qendrën historike të Prizrenit ka qenë i kordinuar mes ICO/EUSR dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Gjatë dy viteve, shoqëria civile dhe qytetarët e Prizrenit kanë qenë tërësisht të përjashtuar nga procesi i hartimit. Ky është nivel mjaft i rrezikshëm i mbylljes, i cili rrezikon të prodhojë pasoja të pariparueshme për qytetarët e Prizrenit, që do të preken drejtpërdrejtë, në përditshmërinë e tyre nga pasojat e këtij ligji nga momenti kur do të fillojë implementimi i tij. Në të njëjtën kohë, kjo mbyllje ngrit edhe shumë dyshime tjera, sidomos për motivet që qëndrojnë pas kësaj përpjekjeje për të kontrabanduar një ligj kaq të ndieshëm për qytetin e Prizrenit.
- Menaxhimi urban i qendrës historike – e gjithë përmbajtja e projekt-ligjit përbëhet nga ndalesa, ndëshkime, procedura, emergjenca, favorizime dhe mbindërtime institucionale, aspekte këto të cilat do të duhej të rregulloheshin kryesisht me akte nën-ligjore. Në vend të tyre, qendra historike e Prizrenit ka nevojë për një ligj që fut menaxhimin urban si koncept të ruajtjes dhe zhvillimit. Koncepti i menaxhimit urban të qendrës historike do të ofronte qasje kreative jo vetëm ndaj shfrytëzimit të potencialit zhvillimor (trashëgimia kulturore, kultura, turizmi), por edhe ndaj

relaksimit të marrëdhënieve mes komuniteteve, të dyja këto kategori seriozisht të rrezikuara nga përmbajtja dhe qasja aktuale e projekt-ligjit për qendrën historike të Prizrenit.

- Favorizimi i Kishës Ortodokse Serbe në raport me të tjerët – në projekt-ligj thuhet se do të kërkohet pajtimi i Kishës Ortodokse Serbe për çdo aktivitet, i cili prek pronat e Kishës Ortodokse Serbe në Qendrën Historike të Prizrenit në pajtim me Aneksin 5 të Propozimit Gjithëpërfshirës të Zgjidhjes dhe Kushtetutën. Edhe pse në dukje të parë lihet përshtypja se ky ligj konsideron të barabartë të gjitha komunitetet fetare, ky formulim, i jep një zë shtesë Kishës Ortodokse.
- Këshilli për Zbatim dhe Monitorim nuk është funksional – Neni 8, paragrafi i parë i Ligjit për Zonat e Veçanta të Mbrojtura (20 shkurt 2008) parasheh që Zona e Veçantë e Mbrojtur për Qendrën Historike të Prizrenit do të themelohet nga organet komunale të Prizrenit në bashkëpunim me KZM. Ky Këshill nuk është konstituuar ende, duke e bërë kështu të pamundur themelimin e Qendrës Historike të Prizrenit edhe nëse miratohet ligji nga Kuvendi i Kosovës.
- Nuk parashihen kompensimet – pasi që imponon një sërë ndalesash, projekt-ligji nuk ofron kurrfarë kompensimesh, lehtësimesh ose stimulimesh për pronarët e shtëpive, afaristët dhe të tjerët që jetojnë dhe punojnë brenda qendrës historike të Prizrenit dhe do t'u ndalohen shumë aktivitete (ndërtim, zgjerim prone, rritje biznesi, etj.).
- Bordi Kulturor i Qytetit dhe autonomia financiare e QHPz – në vend të Zyres së Qendrës Historike të Prizrenit, propozojmë një model të ri të menaxhimit të kulturës në nivel të komunës. Sipas këtij modeli kultura do të menaxhohej nga një Bord i pavarur i qytetit, ku do të ketë pjesëmarrës nga shoqëria civile, komunitetit artistik, komunitetet fetare dhe qeveria lokale. Ky Bord do të udhëhiqte me politikat kulturore të Prizrenit dhe do të menaxhonte buxhetin për kulturë. Në të njëjtën kohë, Bordi do të ishte përgjegjës në nivel operativ për qendrën historike të Prizrenit duke u kujdesur për menaxhimin e saj dhe qëndrueshmërinë financiare. Për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të qendrës historike, propozojmë që të gjitha tatimet e vjelura brenda saj të kthehen në buxhetin e këtij Bordi, i cili do të sigurohej që ato mjete të kanalizohen në qendrën historike në formë të projekteve, investimeve, mirëmbajtjes, restaurimeve, menaxhimit, zhvillimit turistik, etj.
- Disa nga shqetësimet tjera - Funksionimi i Komitetit për Qendrën Historike nuk është i rregulluar dhe lihet hapësirë për interpretime të lira; Pjesëmarrja e shoqërisë civile në këtë Komitet është minimaliste, ndonëse nga formulimi krijohet përshtypja e kundërt; Transportimi i mallrave me ngarkesë të lartë duhet të ketë një zgjidhje më praktike...

Organizatata e nënshkruara:

*EC Ma Ndryshe,*

*Dokufest,*

*Fondacioni për Trashëgimi Kulturore,*

*Forumi për Trashëgimi Kulturore,*

*Academy for Training and Technical Assistance,*

*N'GO,*

*Instituti Demokratik i Kosovës – dega në Prizren dhe*

*X40*